



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-M2/02-3856
Datë: 12.03.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 78 paragrafin 2, nenin 79 paragrafin 2 dhe 6, nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Vendimin e Inspektoratit të Arsimit me referencë 10/06 dhe numër protokolli 032/2024 të datës 23.02.2024 dhe kërkesën numër 04-96 të datës 07.03.2024 të parashtruar nga Drejtoria e Arsimit, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësit Shefqet Dinaj i sistemuar Drejtor në SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan i **vazhdohet kontrata e punës** në pozitën e Drejtorit në të njëjtin institucion për periudhën kohore katër (4) vjeçare, nga data **23.02.2024** deri me datë **24.02.2028**;
2. Kompensimi i pagës mujore të bëhet **sipas koeficientit 6.2** (klasa E14 sipas Ligjit numër 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik);
3. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore brenda afateve ligjore duhet të bëjë përditësimet e nevojshme në kontratën e nëpunësit të shërbimit publik sipas nenit 82 paragrafit 3 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik;
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A R S Y E T I M

Nëpunësit Shefqet Dinaj i sistemuar Drejtor në SHFMU "Ukshin Miftari" në Skivjan pas vlerësimit të performancës dhe rezultateve të mira të punës në menaxhimin e shkollës, u rekomandua që t'i vazhdohet kontrata e punës në pozitën e Drejtorit në të njëjtin institucion për periudhën kohore katër (4) vjeçare. Andaj, bazuar në nenin 13 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 78 paragrafin 2, nenin 79 paragrafin 2 dhe 6, nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Vendimin e Inspektoratit të Arsimit me referencë 10/06 dhe numër protokolli 032/2024 të datës 23.02.2024 dhe kërkesën numër 04-96 të datës 07.03.2024 të parashtruar nga Drejtoria e Arsimit, nëpunësit Shefqet Dinaj i vazhdohet kontrata e punës sipas dispozitivit të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit të Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunësit Shefqet Dinaj
- Drejtorisë për Arsim
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës